

Statistikat e Kulturës

Tremujori I - 2018


Tiranë, më 2 Maj 2018: Numri i shfaqjeve kulturore në tremujorin e parë 2018 është 344, duke pësuar një rritje me 61,5 % krahasuar me tremujorin e parë 2017. Në tremujorin e parë 2018 numri i spektatorëve është 74.848, duke pësuar rritje me 73,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.1 Numri gjithsej i shfaqjeve / ekspozitave në institucionet kulturore

Numri i shfaqjeve/ekspozitave	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.1 2017-Tr.1 2018)
Teatri Kombëtar Popullor	36	43	8	56	44	22,2
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	12	21	5	61	24	100,0
Teatri Kombëtar Eksperimental	102	76	10	132	207	102,9
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	8	15	22	20	18	125,0
Galeria Kombëtare e Arteve	2	5	3	7	0	-100,0
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	53	57	18	59	51	-3,8
Shfaqje kulturore gjithsej	213	217	66	335	344	61,5

Pjesëmarrja mesatare në tremujorin e parë 2018 është 218 spektatorë/vizitorë për shfaqje, dhe ka pësuar rritje me 7,4 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017.

Fig.1 Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje/ekspozitë



Tab.2 Numri gjithsej i spektatorëve/vizitorëve në institucionet kulturore

Numri i spektatorëve /vizitorëve/audiencia	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.1 2017-Tr.1 2018)
Teatri Kombëtar Popullor	12.310	12.575	3.617	19.888	13.963	13,4
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor	7.779	16.693	4.583	28.000	12.256	57,6
Teatri Kombëtar Eksperimental	13.647	10.974	1.559	17.389	40.555	197,2
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	360	660	550	960	401	11,4
Galeria Kombëtare e Arteve	1.141	5.841	4.633	27.123	1.334	16,9
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	7.918	7.396	2.757	8.353	6.339	-19,9
Shfaqje kulturore gjithsej	43.155	54.139	17.699	101.713	74.848	73,4

Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve kulturore, 207 shfaqje/ekspozita në tremujorin e parë 2018. Numri i spektatorëve në tremujorin e parë 2018, është 40.555, duke shënuar rritje prej 197,2 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017. Numri mesatar i spektatorëve gjatë tremujorit të parë 2018 është 196 spektatorë/vizitorë për shfaqje me një rritje prej 46,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Numri i shfaqjeve kulturore të realizuara nga Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë në tremujorin e parë 2018 është 51 shfaqje/ekspozita, duke shënuar rënie me 3,8 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017. Në tremujorin e parë 2018, numri i spektatorëve është 6.339 duke shënuar rënie me 19,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Numri mesatar i spektatorëve në tremujorin e parë 2018 është 124 spektatorë/vizitorë për shfaqje duke pësuar rënie me 16,8 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Tab. 3 Vizitorë në Muze, Parqe Arkeologjike dhe Kala

Numri i vizitorëve	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.1 2017-Tr.1 2018)
Muze	13,327	56,375	78,479	52,805	24,477	84
Kala e Monumente të tjera	12,962	58,059	102,621	27,506	18,075	39
Parqe Arkeologjike	8,606	71,773	150,859	29,650	13,872	61
Numri i vizitorëve gjithsej	34,895	186,207	331,959	109,961	56,424	62

Numri i vizitorëve në muze në tremujorin e parë 2018 është 24.477, duke shënuar rritje me 83,7 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017. Në kala e monumente të tjera, numri i vizitorëve ka një rritje prej 39,4 %, ndërmjet tremujorit të parë 2018 dhe të njëjtëit tremujor në vitin 2017. Në tremujorin e parë 2018 numri i vizitorëve në parqe arkeologjike është 13.872, me një rritje prej 61,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Tab. 4 Frekuentimi dhe botimet në Bibilotekën Kombëtar

Treguesit	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.1 2017-Tr.1 2018)
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	38	22.524	24.798	24.941	5.098	-86,7
Frekuentimi	36	26.294	29.552	32.150	4.987	-86,0
Numri i botimeve	5	3.322	2.851	5.464	1.812	-62,8
Numri i titujve të rinj gjatë vitit	927	661	609	1.046	340	-63,3
Numri i ekzemplarëve të rinj gjatë vitit	4	2.661	2.242	4.418	1.472	-62,7

Numri i shërbimeve të njësive bibliotekare dhe numri i frekuentuesve të Bibilotekës Kombëtare në tremujorin e parë 2018 ka pësuar rënie me rreth 86,0 % krahasuar me tremujorin e parë 2017. Në tremujorin e parë 2018, në Bibilotekën Kombëtare janë afishuar 1.812 botime, 62,8 % më pak në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga këto botime 340 ishin tituj të rinj dhe 1.472 ekzemplarë të rinj.

Shënime Metodologjike

Në institucionet qendrore të artit përfshihen: Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP), Teatri Kombëtar (TK), Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" (TKEKS), Galeria Kombëtare e Arteve (GKA), Cirku Kombëtar (CK), Arkivi Qendror Shqiptar i Filmit (AQSHF), Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave (QKKFTK), Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), Muze, Parqe Arkeologjike dhe Kala.

Të dhënat e statistikave të kulturës sigurohen nga Ministria e Kulturës.